Ne Fokus/ Fanatics "shampo per morra" Dukes dhe Jeminit

nga AlbaniaSoccer
E shtunë, 19 Tetor 2013 19:22

Tifozet e Tiranes nuk i kane harruar akoma veprimet tendecioze qe gjyqtari Lorenc Jemini beri nje jave me pare ne derbin e humbur me Partizanin. Pak dite pasi trajnerit Nevil Dede deklaroi se ne FSHF kane zene morra, grupimi Fanatics ka gjetur nje ide origjinale per te ironizuar FSHF-ne dhe gjyqtarin Jemini. Fanatics i kane nisur me poste ne adresen e shtepise gjyqtarit Lorenc Jemini dhe presidentit te FSHF-se Armando Duka dy kuti me shampo kunder morrave. Ky veprim eshte pritur me entuziazem nga tifozet e shumte bardheblu qe nuk harrojne menyren se si Jemini i detyroi te humbisnin derbin.